

# Regjistrohuni për të marrë fjalën në Takimin e Komisionit të Reformës Shkollore (SRC)

## Komente Publike

### Sipas Seksionit 6: Komente Publike të Politikës 006 të KRSH-së: Takimet:

- a. KRSH(Komisioni Reformës Shkollore) riafirmon të drejtën e publikut për ti dhënë komente KRSH-së mbi çështje të problemeve të përgjithshme, veprimeve formale të KRSH, ose mund të paraqitet për t'i trajtuar përpara KRSH-së.
- b. Publiku mund t'i dërgojë komentet KRSH me shkrim në zyrën e vendosur në 440 North Broad Street, dhoma101, Filadelphia, PA 19130.
- c. Publiku mund t'i paraqesë këto komente përmes regjistrimit në adresën e KRSH-së për takimet e planifikuara në mënyrë të rregullt, ose ato speciale. Procedurat për t'ju adresuar KRSH-së janë si më poshtë:
  - i. Individët mund të regjistrohen nëpërmjet Zyrës së Angazhimit të Prindërve, Komunitetit dhe Familjes në Drejtorinë Arsimore, duke telefonuar në numrin 215-400-4180, jo më vonë se ora 4:30 PM në ditë pune, duke përcaktuar çështjen për të cilën ai/ajo dëshiron t'i adresohet KRSH-së;
  - ii. Individët duhet të regjistrohen në emrin e tyre, ata nuk mund të regjistrohen në emër të një individi tjetër;
  - iii. Individët që përfaqësojnë një organizatë duhet të identifikojnë organizatën në kohën e regjistrimit, dhe nuk mund të regjistrohet më shumë se një përfaqësues për të folur në një takim;
  - iv. Individët duhet të paraqesin emrat, adresën, numrin e telefonit gjatë ditës dhe tematikën, të cilën ata mendojnë të trajtojnë në KRSH;
  - v. Individët duhet të sjellin shtatë kopje me shkrim të komenteve të tyre në takim
    1. Individët nuk mund të flasin më shumë se tre minuta;
    2. Për një problem të caktuar nuk mund të flasin më shumë se gjashtë individë nga njëra palë, ndonse nuk ka limit për individët që të dorëzojnë kopjet e tyre me komente në KRSH, për rishikim;
    3. Individëve nuk do t'u pranohen komentet ose ankesat rreth punës së nëpunësve të veçantë të Drejtorisë Arsimore dhe do të adresohen, që komentet e tyre t'i drejtojnë tek administratori përkatës i Drejtorisë Arsimore.
    4. Individët do t'u hiqet e drejta e fjalës, nëse ata tentojnë të bëjnë vërejtje të natyrës personale për persona të tjerë, pavarësisht nëse ky person është prezent apo jo; dhe
    5. Individëve do t'u pritet fjala dhe do të kërkohet të largohen nga takimi, nëse ata përdorin gjuhë vulgare apo fyese.
- vi. Kryetari i KRSH-së, në gjykimin e tij/saj, mund të pezullojë ose të ndryshojë ndonjë nga procedurat që lidhen me adresimin në KRSH.